



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT I TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr/Br.

1091/20

Datë/Datum.

12.01.21

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

PRISHTINË - PRIŠTINA

PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.1091/20

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik “VLERA” SH.P.K Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “**DDD. SH.P.K.**” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi i objekteve për nevojat e Komunës së Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 616-20-3281-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK -PRISHTINË”, më datën: 11.01.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorëve ekonomik “VLERA” SH.P.K Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Dezinfektimi i objekteve për nevojat e Komunës së Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 616-20-3281-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK -PRISHTINË”.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi i objekteve për nevojat e Komunës së Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 616-20-3281-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK -PRISHTINË”, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “VLERA” SH.P.K Prishtinë, aprovohet pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues “VLERA” SH.P.K Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 14.12.2020 me nr. 1091/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi i objekteve për nevojat e Komunës së Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 616-20-3281-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK -PRISHTINË”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 59, 60, 66 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 15.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit dhe ekspertin teknik për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues/eksperti teknik i prokurimit në raportin e dt: 22.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

**Sqarim hyrës:** “KK –PRISHTINË” gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës kontratë publike kornizë – Shërbim. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës. Kundër të njëjtit propozim parashtruesi i ankesës ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim tek AK, sipas afateve të parapara me LPP. AK përmes vendimit ka refuzuar kërkesën si të pa bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore te OE “VLERA SH.P.K”

Sa i përket pretendimit ankimor të operatorit ekonomik "VLERA SH.P.K" për pikën 1, si: OE nuk ka sjell dëshmitë që pajisjet tona kanë spërkatje 5-50 mikron dhe 5-30 mikron.

Eksperti shqyrtues/teknik sqaron se në dosjen e tenderit - III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, pika 8. Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit –ULV Elektrostatike – min. 3 copa me spërkatje 5-50 mikron , - Pompa dore profesionale Nebulizator elektrik dore me spërkatje 5-30 mikron – min. 2 copa, - Pompa motorike LV – 5 copa - Automjete të pershtatshme për këto aktivitete - 3 copa, tek Dëshmi e kërkuar nuk është cekur se si duhet të dëshmohet një gjë e tillë vetëm se kërkohet të dëshmohet pronësia me faturë të blerjes, librezë të qarkullimit të automjeteve, DUD doganor ose kontratë të marrjes me qira për këtë aktivitet. Përveç kësaj OE ankues e ka dëshmuar këtë përmes letër sqarimit të kërkuar nga AK, një gjë e tillë e pranon edhe AK përmes vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE vlera të dt. 03.12.2020, ku thuhet:

- **Pretendimet tuaja se ju keni dorëzuar sqarime për pajisje është i saktë**, mirëpo komisioni profesional ka konstatuar se ato nuk janë pajisje sipas specifikave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Ne si ekspert konstatojmë se në bazë të specifikave të paraqitura, këto pajisje janë të mjaftueshme për kryerjen e këtyre aktiviteteve

Sa i përket pretendimit ankimor të OE "VLERA SH.P.K" për pikën 2, si: "OE nuk ka sjell dëshmi për 5 pompa LV".

Eksperti shqyrtues/teknik sqaron se OE ankues ka ofruar dëshmi për 5 pompa motorike LV të cilat i shikuan tek Lista e Pajisjeve, fatura 401102 nga Agromarket kodi i Produktit 38107 (Sperkatëse Motorike DM ), gjithashtu të bashkangjitur, një gjë e tillë e pranon edhe AK përmes vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE vlera të dt. 03.12.2020, ku thuhet:

- **Pretendimet tuaja se ju keni dorëzuar sqarime për pajisje është i sakte**, mirëpo komisioni profesional ka konstatuar se ato nuk janë pajisje sipas specifikave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Ne si ekspert shqyrtues/teknik sqarojmë se për aq sa janë kërkuar specifika teknike, këto pajisje i përgjigjen këtyre specifikave për kryerjen e aktiviteteve të parapara në këtë aktivitet të prokurimit, përndryshe është dashur që të kërkohen specifika më të detajuara.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE "VLERA SH.P.K" për pikën 3, si: OE ka sjell vetëm një ISO certifikatë, mirëpo nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara nga AK Certifikatën e analizave dhe MSDS të produktit që do të përdoret"

Ne si ekspert shqyrtues/teknik kemi shikuar me shumë kujdes ofertën e OE ankues Vlera dhe kemi vërtetuar se OE ka ofruar certifikatat ISO, Certifikatën e analizave dhe MSDS të produktit që do të përdoret”, të bashkëngjitur tek “12.ATESTET,ANALIZAT.MSDS, CERTIFICATAT.” një gjë të tillë e pranon edhe AK përmes vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE vlera të dt. 03.12.2020 , ku thuhet:

- **Po ashtu pretendimi juaj se me sqarimet e dorëzuara keni paraqitur edhe dokumentet MSDS dhe Certifikatën e analizave të preparatit është i saktë**, mirëpo preparati i paraqitur nga ju nuk plotëson kërkesat e Aneksit 1 të Autoritetit Kontraktues, pasi që nuk është me përbërjen e kërkuar.

Sa i përket pretendimit të AK-së për OE ankues Vlera, ku thuhet se preparati i paraqitur nga ju nuk plotëson kërkesen e Aneksit 1 të AK-së, pasi që nuk është me përbërjen e kërkuar.

Ne si ekspert shqyrtues/teknik e shikuam me shumë kujdes ofertën e OE ankues dhe e krahasuam me kërkesat e kërkuara ne Aneksin 1, ku vijmë në përfundim se OE ankues ka ofruar produktin me përbërje Peroxyacetic Acid, 15% Hydrogen Peroxide, 10%, ashtu siç kërkohet në Aneksin1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME, ku thuhet:

- **Ne Si Operator VLERA SH.P.K. Do I Perdorim Keto dezinfektues Te Paraqitur Ne Aniksin 1 Peroxyacetic Acid ,15% Hydrogen Peroxide,10%**

Eksperti shqyrtues, lidhur me pretendimin e OE ankues se kompania ne fjale DDD.SH.P.K. nuk posedon Certifikatën e Analizave te Produktit , vetëm MSDS-në. Ne ofertën e dorëzuar ne sistemin e e-prokurimit, OE i rekomanduar për kontrate, nuk e ka dorëzuar certifikatën e analizave.

Lidhur me pretendimin se kompania në fjalë ka ofruar vetëm një Pompë elektrike ULV elektrostatiqe 5-50 micron përmes faturës nr.19-SHV01-001-1682 kurse pajisjet tjera janë Nebulizator dhe Pompa ULV qe vendosen ne veture për Dezinsektim Hapësinor qe fare nuk janë kërkuar në dosje. Eksperti shqyrtues/teknik pas analizimit të specifikave teknike të pajisjes së ofruar vlerëson se i njëjti i ka plotësuar specifikat teknike.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se kompania në fjalë ka ofruar 2 certifikata të kompanisë të ISO standardeve të kërkuara në dosje, por për asnjërën nga ato nuk kemi gjetur që ekzistojnë ose që janë valide, praktikisht kjo kompani ka ofruara Dokumente fallco sepse në ëebfaqen e shkruar ne certifikate për te vërtetuar validitetin e tyre dhe ekzistencën e tyre del qe kompania DDD.SH.P.K nuk i posedon këtë certifikate.

Eksperti shqyrtues/teknik, vlerëson se për çdo dyshim, AK-ja gjatë rivlerësimit të ofertave konform nenit 72 të LPP-së të verifikoj validitetin dhe origjinalitetin e certifikatave ISO.

**Mendimi i ekspertit shqyrtues:** Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **aprovohet si pjesërisht e bazuar**, ndërsa vendimi për dhënie të kontratës të anulohet dhe lënda të kthehet në **rivlerësim**.

Autoriteti kontraktues me datë 24.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik me datë 22.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues/teknik të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Sa i përket pretendimit ankimor të operatorit ekonomik "VLERA SH.P.K" për piken 1, si: OE nuk ka sjell dëshmitë që pajisjet tona kanë spërkatje 5-50 mikron dhe 5-30 mikron.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se në dosjen e tenderit - III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, pika 8. Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit –ULV Elektrostatike – min. 3 copa me spërkatje 5-50 mikron , - Pompa dore profesionale Nebulizator elektrik dore me spërkatje 5-30 mikron – min. 2 copa, - Pompa motorike LV – 5 copa - Automjete të pershtatshme për këto aktivitete - 3 copa, tek Dëshmi e kërkuar nuk është cekur se si duhet të dëshmohet një gjë e tillë vetëm se kërkohet të dëshmohet pronësia me faturë të blerjes, librezë të qarkullimit të automjeteve, DUD doganor ose kontratë të marrjes me qira për këtë aktivitet. Përveç kësaj, OE ankues e ka dëshmuar këtë përmes letër sqarimit të kërkuar nga AK, një gjë e tillë e pranon edhe AK përmes vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE vlera të dt. 03.12.2020, ku thuhet:

- **Pretendimet tuaja se ju keni dorëzuar sqarime për pajisje është i saktë**, mirëpo komisioni profesional ka konstatuar se ato nuk janë pajisje sipas specifikave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se në bazë të specifikave të paraqitura, këto pajisje janë të mjaftueshme për kryerjen e këtyre aktiviteteve.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE "VLERA SH.P.K" për pikën 2, si: "OE nuk ka sjell dëshmi për 5 pompa LV".

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se OE ankues ka ofruar dëshmi për 5 pompa motorike LV të cilat i shikuan tek Lista e Pajisjeve, fatura 401102 nga Agromarket kodit i Produktit 38107 (Sperkatëse Motorike DM ), gjithashtu të bashkangjitur, një gjë të tillë e pranon edhe AK përmes vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE vlera të dt. 03.12.2020, ku thuhet:

- **Pretendimet tuaja se ju keni dorëzuar sqarime për pajisje është i sakte**, mirëpo komisioni profesional ka konstatuar se ato nuk janë pajisje sipas specifikave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se për aq sa janë kërkuar specifika teknike, këto pajisje i përgjigjen këtyre specifikave për kryerjen e aktiviteteve të parapara në këtë aktivitet të prokurimit, përndryshe është dashur që të kërkohen specifika më të detajuara.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE "VLERA SH.P.K" për pikën 3, si: OE ka sjell vetëm një ISO certifikatë, mirëpo nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara nga AK Certifikatën e analizave dhe MSDS të produktit që do të përdoret"

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se është shikuar me shumë kujdes oferta e OE ankues "Vlera" dhe ka ofruar certifikatat ISO, Certifikatën e analizave dhe MSDS të produktit që do të përdoret", të bashkëngjitur tek "12.ATESTET,ANALIZAT.MSDS, CERTIFICATAT." një gjë të tillë e pranon edhe AK përmes vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE vlera të dt. 03.12.2020 , ku thuhet:

- **Po ashtu pretendimi juaj se me sqarimet e dorëzuara keni paraqitur edhe dokumentet MSDS dhe Certifikatën e analizave të preparatit është i saktë**, mirëpo preparati i paraqitur

nga ju nuk plotëson kërkesat e Aneksit 1 të Autoritetit Kontraktues, pasi që nuk është me përbërjen e kërkuar.

Sa i përket pretendimit të AK-së për OE ankues Vlora, ku thuhet se preparati i paraqitur nga ju nuk plotëson kërkesën e Aneksit 1 të AK-së, pasi që nuk është me përbërjen e kërkuar.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se pas shqyrtimit të ofertës së OE ankues dhe krahasimit me kërkesat e kërkuara në Aneksin 1, ku rezultuar se OE ankues ka ofruar produktin me përbërje Peroxyacetic Acid, 15% Hydrogen Peroxide, 10%, ashtu siç kërkohet në Aneksin 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME, ku thuhet:

- **Ne Si Operator VLERA SH.P.K. Do I Perdorim Keto dezinfektues Te Paraqitur Ne Aniksin 1 Peroxyacetic Acid ,15% Hydrogen Peroxide,10%**

Lidhur me pretendimin e OE ankues se kompania në fjalë DDD.SH.P.K. nuk posedon Certifikatën e Analizave të Produktit, vetëm MSDS-në. Ne ofertën e dorëzuar në sistemin e e-prokurimit, OE i rekomanduar për kontratë, nuk e ka dorëzuar certifikatën e analizave.

Lidhur me pretendimin se kompania në fjalë ka ofruar vetëm një Pompë elektrike ULV elektrostatiqe 5-50 micron përmes faturës nr.19-SHV01-001-1682 kurse pajisjet tjera janë Nebulizator dhe Pompa ULV qe vendosen në veturë për Dezinsektim Hapësinor qe fare nuk janë kërkuar në dosje. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se pas analizimit të specifikave teknike të pajisjes së ofruar vlerëson se i njëjti i ka plotësuar specifikat teknike.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se kompania në fjalë ka ofruar 2 certifikata të kompanisë të ISO standardeve të kërkuara në dosje, por për asnjërën nga ato nuk kemi gjetur që ekzistojnë ose që janë valide, praktikisht kjo kompani ka ofruara Dokumente falco sepse në ëbfaqen e shkruar në certifikate për të vërtetuar validitetin e tyre dhe ekzistencën e tyre del që kompania DDD.SH.P.K nuk i posedon këtë certifikate.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik, vlerëson se për çdo dyshim AK-ja gjatë rivlerësimit të ofertave konform nenit 72 të LPP-së të verifikoj validitetin dhe origjinalitetin e certifikatave ISO.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues dhe ekspertit

teknik, vjen në përfundim e AK nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72, si dhe të bëjë vlerësimin e tenderëve duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



**Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK "KK PRISHTINË";
- 1x1 OE "VLERA" SH.P.K Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.